



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 336 Prot

Datë 17.02. 2016

AKT PËRPUTHSHMËRIE

Nr. 01, Datë 17.02.2016.

PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA FIER

Në mbështetje të neneve 9 dhe 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar në proces hartimi, të Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit në proces hartimi, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënavë elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Akitit të Përputhshmërisë për Dokumentin e “Strategjisë Territoriale”, Bashkia Fier.
2. Pjesë përbërëse e Akitit të Përputhshmërisë është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumentit të “Strategjisë Territoriale” të Bashkisë Fier.
3. Ngarkohet Bashkia Fier të reflektojë rekomandimet e “Raportit të Vlerësimit Teknik”, sipas hapave të përcaktuara në raport.

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

RAPORTI I VLERËSIMIT

PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA FIER

16.02.2016



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

Subjekti i Përputhshmërisë	Përcaktim / Komente / Rekomandime	Përputhshmëria
<p>Përputhshmëria Ligjore</p> <p>Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, -Neni 4, shkronjat a, b, c, ç, dh, f, h, j, ll -Neni 9, pika 1/a, pika 1/c, pika 1/dh, pika 1/f, pika 1/g; -Neni 9, pika 2, shkronjat a, b dhe c/i, c/ii, c/iii; -Nenet 13, 15, 20, 23, 24, 25.</p> <p>VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" Neni 18, nenet 49, 50, 51, 52, 53.</p>	<p>Sipas nenit 52 të VKM Nr. 671, Strategja Territoriale përban të paktën:</p> <ol style="list-style-type: none"> Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proçes hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor; Analizën metabolike dhe vlerësimin e përgjithshëm të territorit të njësisë vendore; Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor; Identifikimin e problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme; Visionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore; Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore; Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve; Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparrësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë; Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve; Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve; Hartën e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem. 	<p><i>Në përputhje</i></p>
Plani i Përgjithshëm Kombëtar	Bashkia Fier është pjesë e rajonit ekonomik Vlorë-Fier-Berat. Mbi bazën e parashikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar ky rajon do të ketë 3 Qëndra Kryesore përkatësisht bashkinë Vlorë, bashkinë Fier	<p><i>Në përputhje</i></p>



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

	<p>dhe bashkinë Berat. Bashkia Lushnje dhe Kucova parashihen si Qendra Sekondare te Specializuara ndërsa bashkitë e tjera do të janë Qendra Terciare.</p> <p>Orientimet e zhvillimit që rrjedhin nga PPK janë:</p> <p>Zhvillimi Urban:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar vendsos bashkinë Vlorë, Fier dhe Berat si Qendrat Kryesore të rajonit.2. Propozohet bashkia Lushnje si qendra e Specializuar e rajonit.3. Nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit funksional midis qendrave primare urbane, qendrave sekondare urbane dhe të specializuara, si edhe konsolidimin e infrastrukturës së transportit publik, PPK synon të zbusë trendin humbës të popullsisë në rajon.4. Sugeron konsolidimin e zhvillimit urban në qëndrat urbane me qëllim frenimin e fenomenit të shpërhapjes urbane në dëm të tokës bujqësore. <p>Sistemi Natyror:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon eficentimin e venddepozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e venddepozitimeve rajonale sipas standardeve të kuadrit ligjor sektorial.2. Përgjatë luginave të lumenjve, parashikohet të shtrihen korridoret natyrore, të cilat vendojn prioritet përdorimi natyrën dhe bëjnë lidhjen me zonat e mbrojtura mjedisore, parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore, masivet pyjore etj.3. Propozohet ruajtja dhe shtimi i zonave pyjore duke rritur ndjeshëm sipërfaqet e ripyllëzuara.4. Përmirësimin e rrjetit ujor në fushën e
--	---



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

Myzëqesë (kanalet vaditëse dhe kulluese).

Sistemi Ujor:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon rritjen e masave përkatëse me qëllim reduktimin e ndotjeve të ambientit (ndotjen e Lagunës së Karavastasë, Rezervuarëve, degëzimet e lumbit Seman/Vjosë, ndotjen e ajrit ...etj).
2. Propozon rritjen e bashkëpunimit ndërbashkiak me qëllim mbikqyrjen dhe ruajtjen e florës dhe faunës së pasur ujore dhe mbitokësore.
3. Propozon ruajtjen dhe krijimin e parqeve natyrore përgjatë brigjeve të lumenjëve.
4. Propozohet vodosje të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur në të gjitha qendrat urbane pranë brigjeve ujore.

Sistemi Bujqësor:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon ruajtjen e hapësirave territoriale të tokës bujqësore duke ndaluar zhvillimet ilegale në sektorin e ndërtimit në përgjithësi e në tokat bujqësore në veçanti.
2. Propozon ndërmarrjen e politikave nxitëse për bashkëpunimin ndërmjet fermerëve me qëllim krijimin e koorporatave/kooperativave të afta për të qënë konkurencë me simotrat e tyre në rajon.
3. Propozon ruajtjen e traditës vendase të kulturave bujqësore siç është produksi i patates, bostanit, karrota, vreshtave të rrushit, pemëve frutorë, ullishteve, etj.
4. Rekomandon bashkitë përkatëse për marrjen e masave të duhura në aspektin e përmirësimit të rrjetit ujor (kanalet vaditëse / kulluese ...etj)
5. Propozon plotësimin e zinxhirit ekonomiko-bujqësor në agropërpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim).
6. Propozon krijimin e tregjeve rjonale bujqësore ku Lushnja duhet konsideruar si Pol Bujqësor me rëndësi kombëtare. Kjo kërkon



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

parashikimet e nevojshme në instrumentat më të ulët të planifikimit për hapësirat e nevojshme të pikave të grumbullimit, përpunimit dhe transportimit të produkteve bujqësore. Rritjen e cilësisë dhe eficentimin e infrastrukturës që lidh këtë Pol Bujqësor me qendrat e tjera primare urbane, sekondare dhe të specializuara.

Sistemi Infrastrukturor:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar parashikon plotësimin e të gjitha etapave përkatëse (infrastrukturë + funksionim) të projektit Trans Adriatik TAP.
2. Propozon vleresimin e potencialit për shfrytëzimin e linjës energjitike TAP si burim energjie për zhvillim e industrisë së zonës.
3. Propozon ndërmarjen e nismave përkatëse me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të energjisë alternative siç është ajo diellore (parqet fotovoltaike) apo energjisë së erës, parqet eolike etj. Në përputhje me karakteristikat e peizazhit natyror dhe historik, pa e cënuar atë.
4. Propozon studimin e fizibilitetit të potencialeve si dhe riaktivizimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës, gazit natyror ..etj.
5. Në këtë rajon ndodhen 4 termocentrale të vendosura në zonën e Ballshit, Fierit, Kucovës, dhe Vlorës, ku Plani i Përgjithshëm Kombëtar sugjeron studim të integruar për mundësinë e rivitalizimit të tyre në mënyrë të tillë që të mbulojnë kërkesat në rritje të energjisë, si dhe të diversifikojne burimet gjeneruese.
6. Zhvillimin e qendrës së Vlorës si një Hub Ndërkombëtar, nisur nga modalitetet



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

portuale, hekurudhore dhe rrugore që ofron, si dhe zhvillimin e qendrave Fier, Berat si Hube Kombëtare për të përm bushur nevojat e brendshme të modaliteteve.

7. Rivlerësimin e akseve ekzistues: Levan-Vlorë dhe Orikum- Llogara, nisur nga fakti që kalojnë përgjatë ose përmes Zonave të Mbrojtura si Parku i Levanit, i Pishë Poros, në Rezervatin Vjosë- Nartë dhe në Parkun e Llogarasë dhe Karaburunit. Ky rivlerësim sygjerohet të kryhet sipas konceptit te Rrugeve "Green" duke i rehabilituar dhe përshtatur me infrastrukturën specifike. Kjo pikë i referohet kryesisht Strategjisë Sektoriale të Transportit 2008- 2013 ku zbatohet sipas parimit të transportit të qëndrueshëm. Ky i fundit nënkupton optimizimin e kostos, sigurisë së lëvizjes dhe mbrojtjes mjedisore.
8. Integrimit të mëtejshëm dhe mirëfunkcionimin me kapacitet të plotë të stacioneve aktuale të rrjetit hekurudhor .
9. Rigjallërimin e linjës hekurudhore në tërësi dhe stacioneve qe lidhin Vlorë-Shkodër- Mali i Zi, riaktivizimin e stacioneve ekzistues sipas nevojave dhe modaliteteve që mund të ofrojnë.
10. Rrjetin e bicikletave i cili përshkon rajonin referuar rrjetit kombëtar të bicikletave propozuar nga PPK. Në këtë rajon kalojnë Itinerari Bregdetar Turistik dhe Itineraret Horizontale Kombëtare.
11. Trajktoren fizike, në të cilën mund të kalojë Korridori Blu në këtë rajon, përgjatë qendrave: Karavasta- Seman- Pishë Por- Nartë- Orikum- Karaburun- Llogara. Ky segment është pjesë e Itinerarit Bregdetar



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

	<p>Turistik, pjesë e Itinerarit Bregdetar Turistik Kombëtar.</p> <p>12. Segmente të Itinerareve Horizontale që kalojnë në rajon përshkojnë qendrat turistike në Berat- Lushnje- Karavasta- Manastiri i Ardenicës- Parku i Apollonisë nëpërmjet një infrastructure soft për biçikletat, si pjese e itinerarit pejsazhistik me rëndësi për zonën.</p> <p>13. Propozohet parku i Apollonisë si site “UNESCO”.</p>	
Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin	<p>Bashkia Fier është pjesë e Zonës 3, të brezit bregdetar, ku orientimet e zhvillimit përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Marketim të produktit lokal; 2. Pastrimi, zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit vaditës për tokën bujqësore (në zonën e fushës së Myzeqesë); 3. Lidhja e infrastrukturave lokale mes tyre, për të mundësuar aksesin nga bregdeti; 4. Menaxhimi i transportit të kombinuar publik tokësor dhe detar, duke rivitalizuar të gjitha portet e vjetra të peshkimit, molet, ish-portert ushtarake, në stacione formale/zyrtare, në shërbim të turizmit; 5. Kufizimi i ndërtimeve të reja 200m nga vija bregdetare ranore dhe 60 m lartësi nga kuota e reliefit shkëmbor; 6. Të gjitha zhvillimet e reja do të orientohen në qendrat urbane ekzistuese, për të mbrojtur tokën bujqësore që të mos dëmtohet nga zhvillimet urbane; 7. Do të zhvillojë sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë me të gjitha hallkat e përpunimit të produkteve nga këta sektori; 8. Ndërtimet e reja në brezin e parë bregdetar duhet të respektojnë arkitekturën tradicionale të zonës ku zhvillohen dhe duhet të vënë në përdorim materialet lokale; 9. Të hartohen projekte për menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore, dhe plane menaxhimi të monumenteve të kulturës përmes: <ul style="list-style-type: none"> i. infrastrukturave orientuese; ii. infrastrukturave informuese; 	<i>Në përputhje</i>



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

<p>iii. projekteve promovuese.</p> <p>Specifikisht për territorin e Bashkisë Fier –</p> <p><i>Objektivat:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Forcimi i identitetit bujqësor;</i> ▪ <i>Brendimi i produktit vendas;</i> ▪ <i>Zhvillimi i lokaliteteve bujqësore edhe në shërbim të turizmit;</i> ▪ <i>Arsim profesional në bujqësi dhe industri.</i> <p><i>Politikat:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Plotësimi i ciklit të produktit bujqësor nga prodhimi deri te ambalazhimi;</i> ▪ <i>Masa konkrete për mbrojtjen nga rreziqet natyrore;</i> ▪ <i>Aksesim i vlerave natyrore dhe kulturore përmes infrastrukturës me impakt të ulët në mjedis;</i> ▪ <i>Infrastrukturë për arsim profesional.</i>

Rekomandime për fazat e mëtejshme të hartimit të dokumentit të planifikimit për Bashkinë Fier:

<p>Strategja, Objektivat, Projektet Prioritare</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Fazimi i strategjisë dhe objektivave duke patur parasysh një territor në ndryshim të vazhdueshëm, i cili në harkun e 15 viteve në vijim do të ketë zhvillime e nevoja të tjera. Një parashikim i skenareve të mundshme për këtë hark kohor do ndihmonte identifikimin e problemeve/presioneve të ardhshme dhe kundërpërgjigjeve për zgjidhjen e drejtimin e tyre. - Përputhja e rekomandimeve të evidentuara nga analiza SËOT (territori dhe mjedis) me projektet strategjike prioritare për të siguruar efikasitet më të lartë të veprimit në territor. - Detajimi i projekteve prioritare (fishave) edhe me kosto (të përaferta), në mënyrë që të bëhen sa më të prekshme për financues të mundshëm dhe të arrihet në një plan veprimi prioritar paraprak që i shërben Bashkisë. - Monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe objektivave kërkon një sërë treguesish të matshëm, të cilët mund të evidentohet në fazat më të avancuara të PPV.
<p>Planifikimi sipas sistemeve territoriale</p>	<p>Sistemi Infrastrukturor, fokus në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimin e linjës energetike TAP si burim energjie për zhvillimin e industrisë së zonës; - Ndërmarrja e nismave përkatëse me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të energjisë alternative si ajo diellore (parqet fotovoltaikë) apo energja e erës, etj; - Studimin e mundësive të zhvillimit të industrisë nxjerrëse dhe



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

përpunuese të naftës dhe gazit natyror, duke patur parasysh efektet e tyre anësore në mjesid;

- Ndërtimin e stacionit multimodal, i cili në rastin e bashkisë Fier hyn në kategorinë 'kombëtar', dhe lidhja e tij me rrjetin e transportit.
- Rrjetin e bicikletave që përshtkon rajonin referuar rrjetit kombëtar të bicikletave propozuar nga PPK. Në këtë rajon kalojnë Itinerari Bregdetar Turistik dhe Itineraret Horizontale Kombëtare.
- Aktivizimi i zonave të mbrojtura si potenciale turistike nëpërmjet projekteve 'soft', që lidhin bregdetin me fshatrat përgjatë tij.

Sistemi Natyror dhe Bujqësor, fokus në:

- Evidentimin e masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike duke patur parasysh sidomos përblytjet, thatësitrat dhe avancimin e detit në brendësi të tokës, në harkun kohor 15-vjeçar të veprimit të PPV.

Sistemi Ujor, fokus në:

- Nevojat aktuale dhe ato në rritje të popullsisë përfurnizimin me ujë, duke marrë parasysh rrezikun që parashtron fenomeni i kripëzimit të akuifereve në delten e Lumit Vjosa / puset e shpimit në Pishë-Poro.

Sistemi Urban, fokus në:

- Identifikimin e nevojës reale përfundimtare me infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike, duke u ndalur në projektin e Spitalit Rajonal të Fierit- karakterin e tij dhe raportin me spitalin ekzistues; trajtimin e varrezave të qytetit;
- Rehabilitimin e zonave industriale ekzistuese dhe marrëdhënien e tyre me ndërhyrjet e reja, duke përmendur këtu TEC-in e parashikuar edhe nga PPK.

Bazuar në VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", materialet që duhen dorëzuar/botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit përpëra miratimit të dokumentit të Strategjisë Territoriale, janë:

- I. **Nisma e miratuar** dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;
- II. Dokumentet përbërëse të **Strategjisë Territoriale**, ku do të përfshihen:
 1. **Hartat**;
 2. **Relacionin shpjegues**.
- III. **Akti i përputhshmërisë** nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

E RËNDËSISHME



**FORMULARI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA FIER**

Dokumentet zyrtarë për miratim në Këshill Bashkiak dhe KKT janë:

HARTAT, të cilat duhet të paraqesin të paktën:

- a) Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
- b) Vizionin strategik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
- c) Drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;
- d) Objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve.
- e) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit.

RELACIONI SHPJEGUES, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
- b) Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore;
- c) Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;
- d) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë;
- e) Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve.

